

VENDIM
Nr.309, datë 28.1.2005

PËR DHËNIE LICENCE
PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT “KRUJA”

SUBJEKTIT:SHOQËRIA “JU-AL KABËLL KRUJA” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë“, si dhe rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll” të miratuar me vendimin e KKRT-së nr.221, datë 30.3.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “JU-AL Kabëll Kruja” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për të penetruar në qytetin e Krujës, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Licenca bashkëlidhur përmban kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj